



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK
DEPARTAMENTI I KUJDESIT SHËNDETËSOR

Kodi i lëndës: INF 475
Lënda: Psikologji infantile

PROGRAMI I LËNDËS: Psikologji infantile									
Titullari i lëndës:	Erjona Dervishaliaj <i>Dr. në Psikologji</i> _____								
Ngarkesa:	Kredite	Orë mësimi në auditor						Studim individual	Totali
		Leksion	Seminar	Labs	Praktikë	Projekte	Total		
	3 ECTS	15	8	0	10	0	33	42	75
Tipologjia e lëndës	Lëndë ndërdisiplinore / integruese								
Viti akademik /Semestri kur zhvillohet lënda	Viti I, Semestri I								
Lloji i lëndës	Lëndë me zgjedhje								
Programi i studimit	Master profesional në Infermieri Pediatrike								
Kodi i lëndës	INF 475								
Adresa elektronik e titullarit / pedagogut të lëndës	erjona.dervishaliaj@univlora.edu.al								

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT

Përshkrimi i lëndës	<p>Psikologjia infantile është degë e psikologjisë së përgjithëshme dhe kryesisht e asaj të zhvillimit. Ajo trajton problemet kryesore të zhvillimit të fëmijëve, duke bashkuar këndvështrime të ndryshme si ato biologjike, sociale, psikologjike, pedagogjike, të para nën një këndvështrim shkencor. Lënda trajton një tematikë të pasur mbi zhvillimin e fëmijës duke filluar që nga zhvillimi prenatal, perinatal dhe ai i femijerise së hershme dhe të vonë. Zhvillimi është parë nën aspektin biologjik, integrimin sensorial, zhvillimin e njohjes, zhvillimin social e moral, zhvillimin e gjuhës dhe atë të integritetit gjinor. Lënda balancon modelet teorike dhe ato praktike duke gërshetuar kështu anën historike dhe kontekstuale të trajtimit të zhvillimit të fëmijëve.</p> <p>Qëllimi i lëndës është të pasurojë dijet e studenteve me njohuri të vecanta dhe të thelluara mbi zhvillimin psikologjik të fëmijëve, duke gërshetuar teorite klasike dhe bashkëkohore me rrethanat dhe kontekstin e jetës së përditëshme.</p>
Objektivat e lëndës	<ul style="list-style-type: none">▪ Të përshkruajë ndryshimet që ndodhin gjatë gjithë jetës dhe të japi një pamje të përgjithshme të zhvillimit.▪ Të shpjegojë arsyet e zhvillimit nëpërputhje me rregullat, principet, teoritë dhe mekanizmat e përshtatshme.▪ Të krahasojë njerëzit me prejardhje të ndryshme, me histori të ndryshme jetësore dhe histori të ndryshme biologjike.▪ Të lidhe zbulimet e psikologjisë së zhvillimit me zbulimet e fushave të tjera psikologjike.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK
DEPARTAMENTI I KUJDESIT SHËNDETËSOR

Rezultatet e pritshme	<p>Në përfundim të kursit studentët do të jenë në gjendje:</p> <ul style="list-style-type: none">☞ Të kenë bazë teorike të nevojshme për trajtimin e psikologjise së fëmijëve☞ Të përcaktojnë dhe trajtojnë praktikisht problemet që lidhen me zhvillimin e fëmijës☞ Të analizojnë në mënyrë kritike lidhjen me psikologjine feminare▪ Të mendojnë në mënyrë kritike fëmijën nga një pikëpamje e integruar (biologjike, sociale, psikologjike)
------------------------------	---

KONCEPTET THEMELORE

1. Psikologjia infantile studion ndryshimet që ndodhin natyrshëm në lidhje me moshën, në trup, në mënyrën e të mënduarit, në emocione, në sjellje, në mardhenie dhe në rolet e njeriut gjatë gjithë jetës.
2. Psikologjia infantile studjon periudhat paralindjes, nga lindja 18 – 24 muajsh, fëmijërinë e hershme 2 – 6 vjeç, fëmijërinë e vonë 6 – 12 vjeç.

Java	TEMAT E LËNDËS	Literatura referuese	Forma e mësimdhënies
I.	<p>Tema 1. Këndvështrim historik mbi fëmijërinë. Pionierët e psikologjisë së fëmijës</p> <p><i>Në mesjetë edhe disa qindra vite më vonë fëmija shihej si një miniaturë e të rriturve. Fëmijëve iu lejoheshin vetëm pak vite varësiedhe më pas pritej që ata të ishin të rritur edhe pse të vegjël. Në mungesë të mjeteve të planifikimit famiuljar shumë fëmijë që vinin në jetë ishin të padëshiruar. Gjer në shekullin XX puna e fëmijëve ishte një praktikë e pranuar. Punon edhe fëmijët nën moshën 5 – vjeç</i></p>	⁽¹⁾ fq.1-13	Leksion 1 orë
II.	<p>Tema 2. Probleme të psikologjisë së zhvillimit. Teoritë e zhvillimit të fëmijës</p> <p><i>Në teorinë klasike spikoseksuale të Froidit ka dy sekuenca zhvillimi të cilat takohen në dy pika të ndryshme. Sekuenca e parë ka të bëjë me strukturën e personalitetit dhe komponentët bazë, sekuenca e dytë ka të bëjë me statet gjatë të cilave zhvillimi i personalitetit ndikohet në mënyra të ndryshme.</i></p> <p>Seminar 1.</p>	⁽¹⁾ fq.13 - 24	Leksion 1 orë Seminar 1 orë
III.	<p>Tema 3. Modelet njohëse të zhvillimit. Trajtimet mjedisore dhe të të nxënimit</p> <p><i>Teoria konjektiviste e Piazhës sugjeron se dy mekanizma adaptimi dhe organizimi janë përgjegjës për studimin e strukturave konjiktive</i></p> <p>Praktikë 1 – 2.</p>	⁽¹⁾ fq.24-58	Leksion 1 orë Praktikë 2 orë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK
DEPARTAMENTI I KUJDESIT SHËNDETËSOR

Java	TEMAT E LËNDËS	Literatura referuese	Forma e mësimdhënies
IV.	<p>Tema 4. Gjenetika: Konteksti biologjik i zhvillimit. Crregullimet gjenetike. Gjenet dhe sjellja. Nderveprimet e geneve kohore dhe mjedisore</p> <p><i>Riprodhimi njerëzor, mekanizmat e trashëgimisë, tiparet e përcaktuara nga kromozomet e seksit, mutacionet, çrregullimet që shkaktohen nga një gjen i vetëm defektiv dominant apo recesiv, këshillimi gjenetik, gjenet dhe mjedisi</i></p> <p>Seminar 2.</p>	⁽¹⁾ fq.59-94	Leksion 1 orë Seminar 1 orë
V.	<p>Tema 5. Zhvillimi prenatal. Teratologjia.</p> <p><i>Periudha germinale, e embrionit dhe e fetusit; mjedisi prenatal dhe ndikimi në zhvillimin e fetusit.</i></p> <p>Praktikë 3 - 4</p>	⁽¹⁾ fq.94- 119	Leksion 1 orë Praktikë 2 orë
VI.	<p>Tema 6. Lindja, rritja fizike dhe zhvillimi i aftësive. I sapolinduri i organizuar</p> <p><i>Proçesi i lindje, komplikimet e lindjes, praktikat e lindjes, eksperiencat stresante të fëmijës, fëmijët preterm dhe serotinë dhe periudha postnatale.</i></p> <p>Seminar 3.</p>	⁽¹⁾ fq.12- 153	Leksion 1 orë Seminar 1 orë
VII.	<p>Tema 7. Zhvillimi sensor dhe përceptual. Zhvillimi i vemendjes. Zhvillimi i njohjes.</p> <p><i>Kapacitetet shqisore dhe përceptive të të porsalindurit, të parit, të dëgjuarit dhe të shijuarit, të nuhaturit të prekurit; shprehitë motorike.</i></p> <p>Praktikë 5 - 6</p>	⁽¹⁾ fq.154 - 161	Leksion 1 orë Praktikë 2 orë
VIII.	<p>Tema 8. Zhvillimi fizik dhe konjuktiv në foshnjëri.</p> <p><i>Zhvillimi fizik, motorik, përceptiv, konjuktiv, kujtesa e fëmijës, teoria e Piazhës</i></p> <p>Seminar 4</p>	⁽¹⁾ fq.161- 179	Leksion 1 orë Seminar 1 orë
IX.	<p>Tema 9. Zhvillimi psikosocial në foshnjëri.</p> <p><i>Kontributi i fëmijës, karakteristikat fizike, tempëramenti, emocionet e foshnjëskur fillon frikakontributi i prindërve.</i></p> <p>Praktikë 7 - 8</p>	⁽¹⁾ fq.179 - 185	Leksion 1 orë Praktikë 2 orë
X.	<p>Tema10. Atashimi prind fëmijë dhe zhvillimi konceptit për veten</p> <p><i>Sjelljet atashuese; zhvillimi i atashimit; babai dhe figurat e tjera atashuese; teoria e ndarjes dhe individualizimin; studimet për veten dhe vetëdijen.</i></p> <p>Seminar 5.</p>	⁽¹⁾ fq.187 - 198	Leksion 1 orë Seminar 1 orë



REPUBLICA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"
FAKULTETI I SHËNDETTIT PUBLIK
DEPARTAMENTI I KUJDESIT SHËNDETTËSOR

Java	TEMAT E LËNDËS	Literatura referuese	Forma e mësimdhënies
XI.	Tema 11. Zhvillimi fizik në moshën parashkollore. <i>Proporcionet e trupit, pesha, lartësia dhe pamja; ndryshimet strukturore, zhvillimi i trurit, shëndeti në moshën parashkollore.</i>	⁽¹⁾ fq.200 - 206	Leksion 1 orë
XII.	Tema 12. Zhvillimi konjektiv dhe gjuhësor në moshën parashkollore. <i>Stadi paraoperacional; epërsitë e të menduarit paraoperacional; kufizimet e të menduarit paraoperacional, teoria procesimit të informacionit; zhvillimi gjuhësor në moshën parashkollore.</i> Seminar 6.	⁽¹⁾ fq.208 - 233	Leksion 1 orë Seminar 1 orë
XIII.	Tema 13. Zhvillimi psikosocial në moshën parashkollore <i>Koncepti për gjininë; formimi i roleve gjinore; familja dhe fëmija; stilet e prindërimit; efekti i divorcit mbi fëmijën.</i> Praktikë 9 - 10	⁽¹⁾ fq.234- 254	Leksion 1 orë Praktikë 2 orë
XIV.	Tema 14. Zhvillimi fizik dhe konjektiv në fëmijërinë e mesme. <i>Karakteristikat e zhvillimit fizik dhe motorik; zhvillimi konjektiv sipas teorisë së procesimit të informacionit,; stilet konjiktive.</i> Seminar 7.	⁽¹⁾ fq.199-203	Leksion 1 orë Seminar 1 orë
XV.	Tema 15. Zhvillimi konjektiv në fëmijërinë e mesme. <i>Vetëvlerësimi; zhvillimi i kognicionit soicial; arsyetimi moral; maredheniet me moshatarët; familja dhe fëmija.</i> Seminar 8.	⁽¹⁾ fq.205-209	Leksion 1 orë Seminar 1 orë

FORMA E KONTROLLIT TË DIJEVE

FREKUENTIMI:	<p>Kyçi i një edukimi të suksesshem është pjesëmarrja dhe përgatitja. Kërkohet një pjesëmarrje aktive në klasë. Orët e leksionit janë të detyrueshme në masën 75%. Orët e praktikës janë të detyrueshme 100%, në rast të mungesave të justifikuara ora do të zëvendësohet në marrveshje me pedagogun. Të gjithë studentët duhet të paraqiten në orët e praktikës në orarin e përcaktuar dhe të pajisur me përparëse të bardhe dhe flokë të mbledhur (duke respektuar kodin etik të veshjes së infermierit).</p> <p>Lejohen të shlyhen mungesat deri në masën 25% të orëve, nëse ato janë të justifikuara. Në të kundërt studentit humbet të drejtën e futjes në provim. Mungesat janë përgjegjësi personale e studentit, ashtu sikurse edhe detyrat apo testimet e humbura.</p>					
KONTROLLI I VAZHUESHËM	<i>Forma e vlerësimit</i>	<i>Koha e vlerësimit</i>	<i>Temat mësimore që do vlerësohen</i>	<i>Pikët maksimale</i>	<i>Forma e testimit të njohurive</i>	<i>Përmbajtja e testimit</i>
	Provimi final	Fundi i semestrit	Lex 1-15	90 pikë	Provim me shkrim	pyetje me shtjellim dhe pyetje quiz
	Vlerësim i vazhduar* (Detyra e kursit*)	Java 14/15	Rastet klinike	10 pikë	Provim me gojë	Raportim rasti



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK
DEPARTAMENTI I KUJDESIT SHËNDETËSOR

	<i>*Vlerësim i vazhduar</i> - Do të realizohet prej pedagogut për gjatë gjithë semestrit. Studentët do të prezantojnë detyrën me gojë					
	Konvertimi i pikëve në notën përfundimtare është si më poshtë:					
	40- 49 pikë	50-59 pikë	60-69 pikë	70-79 pikë	80-89 pikë	90-100 pikë
5	6	7	8	9	10	

LITERATURA	
Literatura bazë	1) "Psikologjia e zhvillimit të fëmijës" Theodhori Karaj, 2004. ISBN 99927-882-4-0.
Literatura e rekomanduar	<ul style="list-style-type: none">○ By the ages' behavior & development – K.Eileen Allen et al. 2015○ Child Health Psychology. Lawrence Erlbaum Associates, 1988○ Handbook of Clinical Child Psychology 3d Edition. John Wiley & Sons, 2013,○ Handbook of Pediatric Psychology Michael C. Roberts Guilford Press, 2013

VËREJTJE PËRFUNDIMTARE NGA PEDAGOGU I LËNDËS	
Dispozita:	Nga studentët pritet që të zhvillojnë vlera dhe një etike që tregon interesat dhe sjelljen e tyre në këndvështrimin profesional. Këto pritshmëri lidhen me paraqitjen në ambientet e Universitetit, përgjegjshmërinë gjatë procesit të mësimdhënies, por jo vetëm, në ndershmërinë e tyre dhe në çështje të drejtësisë sociale. Studentët duhet të respektojnë diferencat individuale, të jenë bashkëpunues, të vlerësojnë aftësitë dhe cilësitë e vetes e të tjerëve, të vlerësojnë format e ndryshme të shprehjes së mendimit dhe zgjedhjeve të secilit. Në përputhje me rregullat etike, studentët duhet të respektojnë diferencat etnike dhe të ndihmojnë me qëndrime integruese e mbështetëse personat me aftësi të kufizuara.
Vonesat	Vonesat në leksione dhe seminare nuk do të tolerohen. Pas hyrjes së pedagogut në auditor nuk lejohet të hyjë asnjë student.
Sjellja profesionale e studentit	Studentët konsiderohen tashmë të rritur dhe kjo kërkon prej tyre një përgjegjësi dhe vet-ndërgjegjësim në një nivel më të lartë në lidhje me sjelljen e tyre, qëllimet e interesat për të cilat ata kanë zgjedhur të frekuentojnë universitetin. Duke patur parasysh që kudo infrastruktura universitare dhe ekologjia e mjedisit ku jepen dijet nuk është e përsosur, duhet të vendosim disa rregulla të detyrueshme për të gjithë. Kjo d.m.th., vëmendje gjatë procesit mëimor, celularë të fikur, jo SMS, jo përdorim të mjeteve të tjera digitale me destinacion argëtimin (MP3.etj), jo lojra, jo kuti tualeti nëpër tavolinat e mësimin, veshje të përshtatshme për të respektuar orën e mësimin, fjalor (vulgariteti ndalohet rreptësisht) dhe komunikim të pranueshëm brenda dhe jashtë klasës. Për çdo devijancë nga këto rregulla, do të ketë penaltete, që përcaktohen në Rregulloren e Universitetit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK
DEPARTAMENTI I KUJDESIT SHËNDETËSOR

Integriteti akademik dhe e drejta e autorit

Çdo test apo punë me shkrim duhet të jetë tërësisht individuale dhe origjinale. Kjo nënkupton që studentët të krijojnë vetë mbi bazën e koncepteve të argumentuara në leksion abstraksione apo analiza origjinale, dhe në pamundësi të referojnë gjithnjë burimin e informacionit të marrë. Nuk do të lejohen plagjiaturat (përzjerjet mikse), apo vjedhjet e informacioneve në rrugë të ndryshme.